

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fatura e 'kripur' që la pas ish-zyrtari i akuzuar për korrupsion Zjarr.tv
ADRESA	https://zjarr.tv/sq/fatura-e-kripur-qe-la-pas-ish-zyrtari-i-akuzuar-per-korrupsion/
BURIMI	zjarr.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 02:47:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 gusht 2026, 09:37:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	01a29c8acddbfa74d3b5f0bd0ac42d6706ce3a04a1c2407f2d724f01d001061a
TEKSTI	d78618024d8e4f556f3640ed8a2b81077830573823f90af5ccba602c33dbc006
PAMJA	7f15c181a6d5884e49f80a39fecf81bdf23c56bbb4318a73b34396db13169b95

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	45cab54c12bbf90c7ba628df9af13bfe8ab679c2d296cc4cf41499e19b239f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	fd0f30d14deccb517a8ee336538e7a1bfa0b62061de46bf333e5a3dacda14124
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmT5dAMDZwXdaRF86FsqrAV8t4MT2yWbzKVBaCXRmbwk



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/45cab54c12bbf90c7ba628df9af13bfe8ab679c2d296cc4cf41499e19b239f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

[HOME](#) [EMISIONET](#) [AKTUALITET](#) [RAJONI](#) [VENDI](#) [BOTA](#) [SPORT](#) [TË TJERA](#) [ZJARR - TV LIVE](#) [KONTAKT](#)[Ballina](#) [Aktualitet](#) [Fatura e 'kripur' që la pas ish-zyrtari i akuzuar për korrupsion](#)[Aktualitet](#) [kryesore](#) [LAJME](#) [Politike](#) [Vendi](#)

Fatura e 'kripur' që la pas ish-zyrtari i akuzuar për korrupsion

26/08/2026

46 0



Aa Aa

Para se emri i tij të bëhej i njohur në disa prej dosjeve më të bujshme kundër korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës në Shqipëri, nga afera e inceneratorëve të skandali i tenderave i njohur si "5D", Taulant Tusha kishte lënë një tjetër gjurmë të mbresëlënëse në zyrat e shtetit.

Vetëm se këtë herë nuk bëhej fjalë për miliona euro të prokurimeve publike apo kontrata të fshehta ndërtimi, por për diçka në dukje të thjeshtë, e megjithatë thellësisht absurde – 8 fatura telefoni për një total prej mbi 20 mijë eurosh.

Rasti u ekspozua pasi një kompani për mbledhjen e borxheve të këqija e mendoi si një fitim të sigurt arkëtimin e faturës që la pas ish-zyrtari i akuzuar për korrupsion, duke paditur për këtë kosto Ministrinë e Shëndetësisë, e cila e trashëgoi borxhin nga ish-Ministria e Mirëqenies Sociale, në të cilën Tusha shërbeu për një periudhë kohe si Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, emri i së cilës rezultonte në krye të faturës bashkë me atë të ish-drejtorit.

Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i datës 1 korrik 2026, ka nxjerrë në dritë kërkesën e pazakontë, ku kompania "D&Fin Partner" për mbledhjen e borxheve të këqija kërkoi që buxheti i shtetit të paguante afro 20 mijë euro për faturat e papaguara të celularit të Tushës.

Gjyqtari Ardit Kuka e rrëzoi padinë, duke vënë në dukje se kontrata ishte nënshkruar jashtë çdo tagri zyrtar dhe duke qartësuar se abuzimet me shpenzimet telefonike jashtë limiteve të lejuara ligjore të zyrtarëve janë përgjegjësi vetjake e tyre dhe jo barrë e taksapaguesve.

"Eventualisht edhe nëse do të pranohej padia, detyrimi që do të mbulonte ministria do të ishte deri në vlerën maksimale 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë për të gjitha faturat objekt gjykimi. Për pjesën tjetër detyrimi do të duhet t'i kërkohej personalisht përdoruesit të numrit të telefonit", arsyetoi Kuka.

I pyetur nga BIRN, Taulant Tusha tha në telefon se nuk i kujtohej ky numër telefoni.

"Nuk mbaj mend ta kem pasur këtë numër", tha Tusha. Ai tha se nuk kishte dijeni për çështjen dhe as ishte thirrur, as ishte njoftuar.

Kompania "D&Fin Partner" i tha BIRN se u ishte referuar faturave ku përmendej ministria për padinë.

"Kompania, e cila ka blerë borxhin e kompanisë celulare, ka paditur subjektin Ministria e Punës dhe

Në Shqipëri, arkitektët e dalluar nga "revolucionit i flamingove" po fshehin kokën në rërë

Satira e Gjekmarkajt për nismën 'Prania Besnike': Babua flet, ne besojmë; ai vuan, ne qajmë

The Naked Truth-Sali Berisha nisjet drejt Uashingtonit për Konventën Republikane

Shqipëria në luftë me flakët, 39 vatra zjarri, 6 shtëpi të djegura në Himarë

Dhunoi ish-banorin e "Big Brother VIP Kosova", shoqërohet në polici këngëtari Jozefin Marku

Shtator 2026

H	M	M	E	P	S	D
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				

« Gus

çështjeve sociale, duke u bazuar te te orientat e taturimit te taturave te paikuluada, subjekti i paule , tha një zyrtar i kompanisë.

Ai shtoi se ende nuk ishte vendosur nëse çështja do të apelohej.

Vendimi i gjykatës dhe përballja me drejtësinë

Taulant Tusha është një nga ish-zyrtarët më të lartë dhe më jetëgjatë të Bashkisë së Tiranës, i cili, para se të shërbente si Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit të Punëve Publike në Bashkinë e Tiranës, kishte mbajtur postin e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Rënia e tij nga një prej drejtuesve më me ndikim të bashkisë në një të pandehur të drejtësisë nisi në dhjetor të vitit 2023, kur ai u arrestua me urdhër të Prokurorisë së Posaçme, SPAK, i akuzuar për përfshirjen në aferën e inceneratorit të Tiranës, një prej dosjeve më të bujshme të korrupsionit dhe abuzimit me detyrën të hetuara vitet e fundit në Shqipëri, që u ka kushtuar taksapaguesve dhjetëra miliona euro. Tusha është gjetur fajtor dhe dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me 2 vjet burg.

Përveç kësaj akuze, Tusha u bë subjekt i një hetimi të dytë nga SPAK për dosjen e njohur si “SD”, një skemë e dyshuar korrupsioni brenda Bashkisë së Tiranës. Referuar akuzave, SPAK thotë se është provuar fakti që Tusha, në cilësinë e drejtorit të Punëve Publike dhe si anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, KVO, favorizoi në mënyrë të paligjshme shoqërinë “SD Konstruktion” – e zotëruar de facto nga ish-drejtorët e tjerë të bashkisë, Redi Molla dhe Mariglen Qato.

Por ndërsa këto raste janë gjykuar apo janë në gjykim, faturat e shpenzimeve telefonike të viteve 2015-2016 ishin harruar derisa kompania që blen kreditë e këqija mori përsipër vjeljen e tyre.

Në vitin 2025, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kompania “D&Fin Partner”, e cila kishte blerë borxhin nga operatori telefonik Albtelecom (One Albania), i kërkoi gjykatës t’i njihje të drejtën e arkëtimit nga thesari i shtetit. Në kërkesën e saj, paditësi pretendoi se “Detyrimi ka lindur nga marrëdhënia kontraktore... Kontrata është lidhur në emër të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë... prandaj debitori është personi juridik”.

Përballë kësaj kërke, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale u mbrojt duke argumentuar se institucioni nuk kishte asnjë lidhje me këto shpenzime. Përmes Deklaratës së Mbrojtjes, institucioni prapësoi duke theksuar se “Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces, sepse nuk është palë në marrëdhënien kontraktore” dhe se “Kontratat e lidhura midis shoqërisë dhe ministrisë përgjegjëse janë absolutisht të pavlefshme, pasi vijnë në kundërshtim me ligjin”.

Në analizën e tij, gjyqtari Ardit Kuka e gjeti të pabazuar kërkesën e kompanisë mbledhëse të borxheve, duke i dhënë të drejtë ministrisë. Gjykata theksoi defektet thelbësore formale dhe ligjore të kontratës origjinale të pajtimit të vitit 2015. Vendimi arsyeton se “Nuk rezulton që të jetë lëshuar prokurë nga titullari i institucionit në formë noteriale apo autorizim me shkrim... që do t’i jepte tagër Z. Taulant Tusha për të lidhur kontrata të shërbimit telefonik në emër dhe për llogari të ministrisë”.

Për rrjedhojë, gjykata rrëzoi padinë, duke konkluduar se kërkimi “nuk mund t’i kundrejtohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale”, sepse nuk ishte palë në marrëdhënien kontraktore, por duhet t’i drejtohej Taulant Tushës.

Faturat e çmendura

Të dhënat e administruara nga trupa gjyquese tregojnë se në 8 muaj – tetor, dhjetor 2015 dhe janar-qershor 2016 – faturat mujore të lëshuara nga operatori AMC, sot One Albania, përmbanin zëra të detajuar për telefonata, internet dhe shërbime roaming me shifra anormale. Vetëm për muajin tetor 2015, fatura e celularit kapi vlerën marramendëse të 983,948 lekëve me TVSH.

Megjithatë, jo të gjitha faturat ishin njëloj stratosferike. Në disa raste vihet re një rënie e madhe në shpenzime; kështu, nga fatura prej gati 1 milion lekësh të reja në tetor, në dhjetor 2015 fatura shënoi vetëm 7,456 lekë, sërish mjaft më shumë sesa kontrata që parashikonte një abonim mujor prej 5 mijë lekësh.

Ndërkohë, trendi i përdorimit ekstrem u rikthye sërish në janar 2016, kur fatura arriti në 101,805 lekë, ndërsa në shkurt 2016 vlera kërcëu sërish në 428,764 lekë me TVSH. Një tjetër shifër e lartë u shënuar në prill 2016, kur fatura ishte 203,862 lekë, për të zbritur në qershor 2016 në një vlerë mjaft modeste, krahasuar me faturat e mëparshme, prej rreth 2,370 lekësh.

Në vendim, gjykata i gjeti këto shpenzime të paarsyeshme, duke sqaruar se, ndërsa ishte normale që të mbulohehin shpenzimet telefonike për një zyrtar të lartë të administratës publike, ato nuk ishin pa limit dhe ishin të përcaktuara qartë nga legjislacioni me një tavan të pakalueshëm.

Kuadri ligjor në fuqi, që citohet në vendim, bën të qartë se vetëm 5 zyrtarët më të lartë të shtetit – Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurori i Përgjithshëm – kishin shpenzime pa limit.

Ndërkohë, legjislacioni nuk i lejon zyrtarët e nivelit ku ishte i punësuar Tusha të shpenzonin pa limit. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 864, të vitit 2010, që citohet në vendimin e Gjykatës, për kategorinë ku bënte pjesë Tusha, buxheti i shtetit mbulonte shpenzimet për shërbimin telefonik vetëm deri në limitin e 10,000 lekëve në muaj.

Në arsyetimin e tij, gjyqtari Ardit Kuka thekson se edhe në skenarin ku Ministria do të ishte palë legjitime në kontratë, detyrimi maksimal që do të mund t'i ngarkohej thesarit të shtetit për të gjithë këtë periudhë do të ishte jo më shumë se mbledhja e kësaj vlere maksimale.

Vendimi i gjykatës lë të kuptohet se elementi kyç që shërbeu si mburojë për financat publike në këtë përballje gjyqësore ishte forma e nënshkrimit të kontratës origjinale të pajtimit. Ish-drejtori kishte shënuar në hyrje të dokumentit inicialet e institucionit "Taulant Tusha/MMSR", duke lënë të kuptohej një përfaqësim shtetëror, por gjykata zbuloi se ai nuk kishte asnjë autorizim për të vepruar në emër të shtetit.

Vendimi argumenton se: "Nuk rezulton që të jetë lëshuar prokurë nga titullari i institucionit në formë noteriale apo autorizim me shkrim, si nga ministri i kohës ashtu edhe sekretari i përgjithshëm, që do t'i jepte tagër Z. Taulant Tusha për të lidhur kontrata të shërbimit telefonik...".

Për më tepër, gjykata nënvizoi defektet formale të dokumentit, duke konstatuar se në fund të kontratës mungonte nënshkrimi me shënimin përfaqësues, si dhe mungonte vula e ministrisë përkatëse. Kjo e zhvlerësoi natyrën zyrtare të dokumentit, duke e kthyer atë në një veprim juridik privat./reporter.al

Zjarr Tv Ad

 **ALBSIG
INVEST**



Podkaste

Konspiracion / E Vërteta e Fshehur

Fe dhe Spiritualitet

Edukim

Argëtim

Lajme dhe Politikë

Teknologji

Gatim

Të tjera

 **The
naked
Truth®**

PA MASKA. PA FILTRA. 360°.

**Shtëpia e
shumëkërkuar
e çdo krijuesi.**

The Naked Truth tani online.

ERDHI.

 **Abonohu Tani**

Zgjidhni gjuhën e përmbytjes

    **MË SHUMË**

Artikulli paraprak

Flet vajza e shqiptarit që vrau ish-partneren në
Greqi: Ai është babai im, por nuk mund ta
justifikoj

Artikulli tjetër

Pas takimeve në Pogradec, Rama mbledh të
premtën ministrat në selinë e PS

ARTIKUJ TË NGJASHËM

MË SHUMË NGAAUTORI



Në Shqipëri, arkitektët e dalluar nga
"revolucioni i flamingove" po fshehin
kokën në rërë



Satira e Gjekmarkajt për nismën
'Prania Besnike': Babua flet, ne
besojmë; ai vuan, ne qajmë



The Naked Truth-Sali Berisha nisët
drejt Uashingtonit për Konventën
Republikane



Na kontaktoni duke përdorur të dhënat e ofruara më poshtë. Adresa: Zjarr Televizion, Rr. 3 Dëshmorët pll. Jera 3 K.1 Yzberisht NUIS:
L423110171 Phone: +355694299988 & +35544501520

